# PLANI I BUXHETIT 2012

## PLANI I BUXHETIT - I RISHIKUAR

## 2012

Fushë Kosovë
Korrik 2012

**Përmbajtja**

**Faqe**

1. Hyrje.....2
2. Buxheti operativ për vitin 2012.....4
3. Investimet Kapitale 2012 .....6
4. Aneksi 1 (buxheti operativ – sqarimet).....7

## 1. H Y R J E

Kompania - Operim me Trena i Hekurudhave të Kosovës "TRAINKOS Sh.A" ka filluar së vepruari si kompani e ndarë më 1 Shtator, 2011. Procesi i ndarjes së Hekurudhave të Kosovës Sh.A në dy kompani të reja ka përcaktuar që veprimtaria kryesore e Trainkos Sh.A të jetë transporti. Transporti i mallrave dhe udhëtarëve është shërbim publik për të cilin është paraparë zhvillimi i biznesit sipas "Planit të Biznesit 2012" të diskutuar dhe aprovuar në nëntor 2011. Kjo strategji është e mbështetur në deklaratën e precizuar për misionin dhe vizionin e zhvillimit të biznesit të kompanisë për vitin 2012.

***Vizioni***

***Të jemi prijës në transportin e mallrave e sidomos të industrive të rënda brenda vendit me një rritje të vazhdueshme për t'u zgjeruar në rajon, si dhe me shërbime konkurruese, komode dhe me saktësi të lartë, të jemi zgjedhja e parë e udhëtimit për pjesën më të madhe të qytetarëve të vendit. Me qëndrueshmëri financiare dhe ngritje të vazhdueshme ku puna jonë të jetë burim i vazhdueshëm i besueshmërisë së klientëve tanë dhe krenarisë për ne.***

***Misioni***

***Të jemi bartës të zhvillimit ekonomik të vendit duke ofruar zgjedhje konkurruese të transportit dhe me punën tonë të përmirësojmë mirëqenien e qytetarëve tanë.***

Duke u bazuar në të dhënat historike, analizën e tregut, analizën e kapaciteteve teknike dhe analizën financiare janë përcaktuar objektivat e Trainkos Sh.A për vitin 2012. Resurset financiare për realizimin e këtyre objektivave janë strukturuar sipas burimit të krijimit të këtyre resurseve. Burimi kryesor është nga buxheti operativ, pra nga shërbimet për transportin e mallrave që krijohen nga kjo veprimtari kryesore që zhvillon Trainkos Sh.A.
Rrethanat në të cilat zhvillohet veprimtaria kanë ndryshuar nga parashikimet fillestare të paraqitura në Planin e Biznesit 2012 dhe të precizuara në Planin e Buxhetit 2012. Për këtë edhe është punuar në rishikimin e të dy dokumenteve bazë strategjike të kompanisë. Pas analizës detale të rrjedhave të periudhës së semestrit të parë 2012 dhe burimeve të financimit për pjesën tjetër të vitit në total nga shitjet për transportin e mallrave me rishikim parashihen të realizohen 2,004,180.33€, fillimisht është paraparë të realizohet shuma prej 3,446,644.00€.
Duhet potencuar se me rishikim janë prezantuar shifrat të cilat janë pa pjesën e obligimit ndaj Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) si për pjesën e të hyrave poashtu edhe për pjesën e shpenzimeve.
Burim tjetër i financimit është edhe transporti i udhëtarëve. Në total fillimisht janë paraparë të realizohen 1,836,959.00€, kurse me rishikim parashihen të realizohen 1,664,834.18€. Nga shitja e biletave kanë qenë paraparë të realizohen 245,000.00€, me rishikim 223,523.34€. Kurse nga subvencioni i aprovuar me Buxhetin e Kosovës për vitin 2012 dhe përfitimi nga marrëveshja për Trenin e Lëvizjes së Lirë (TLL), në total jenë paraparë 1,591,959.00€, kurse me rishikim janë 1,441,307.84€. Shuma prej 1,091,959.00€ është buxhetuar për transportin humanitar, konkretisht për qarkullimin e TLL-së. Me rishikim me kalkulimet tona del se e hyrë do të jetë

shuma prej 941,307.84€. Kurse subvencioni prej 500,000.00€ është për mbulimin e humbjeve nga trenat tjerë që i ka në funksion Trainkos Sh.A.
Shuma prej 287,000.00€ fillimisht është kalkuluar nga të hyrat që vijnë nga ofrimi i shërbimeve tjera, me rishikim parashihen të realizohen 188,634.74€. Nga këto burime të financimit me rishikimin e buxhetit për vitin 2012 në total parashihen të realizohet shuma prej 3,857,649.26€ përkundër parashikimeve fillestare që kanë qenë 5,570,603.00€.
Të hyrat tjera jo operative kanë qenë të buxhetuar në një kategori të posaçme në shumën prej 5,000.00€ nga shitja e mbeturinave dhe mjetet e akumuluara prej 320,203.00€. Me realitetin e krijuar brenda semestrit të parë të vitit 2012 del se do të krijohen të hyra jo operative siç janë: Të hyrat nga shitja e naftës Infrakosit – 60,062.83€ (kjo shumë e njëjtë korrespondon me shpenzimin e precizuar te kostoja e shërbimit); Të ardhurat nga mirëmbajtja e vagonëve – 28,824.66€ dhe mjetet e akumuluar – 316,669.94€.

Realizimin e shitjeve nga veprimtaria e cekur më lart me rishikim planifikohet të realizohet një kosto për shërbimet, konkretisht blerja e materialeve sipas kategorive shpenzuese adekuate. Kostoja totale e kësaj kategorie do të jetë 2,955,838.11€, fillimisht janë parashikuar 3,736,082.00€. Në këtë kategori bën pjesë edhe pozicioni – qasja në binarë, kalkulimet e bëra në fillim janë bazuar në marrëveshjen në fuqi të vlefshme deri në fund të vitit 2011 dhe që ka vazhduar edhe në vitin 2012 në shumën prej 1,608,000.00€, kurse me rishikim (pa TVSh) janë paraparë 1,386,206.63€ për tërë vitin 2012.
Duhet ta kemi parasysh që finalizimi i draftit dhe fillimi i zbatimit të Deklaratës së Rrjetit me ndryshime të dukshme nga këto kalkulime do të ndryshojë gjendjen e raporteve të aprovuara në mes të shitjeve dhe kostos së shërbimeve.

Buxheti i planifikuar për shpenzimet e stafit për vitin 2012 fillimisht ka qenë 1,410,000.00€, kurse me rishikim parashihen 1,403,330.00€.

Te kategoritë shpenzuese, shpenzimet operative gjatë vitit 2012 fillimisht janë planifikuar të realizohet shuma prej 439,686.00€, kurse me rishikim parashihen 301,760.68€.

Kategoria e shpenzimeve administrative fillimisht është buxhetuar në shumën prej 322,400.00€, kurse me rishikimi parashihen 111,749.29€ për tërë vitin 2012.

## 2. BUXHETI OPERATIV I TRAINKOS SH.A PËR VITIN 2012

| Kodi | Shitjet | Buxheti i rishikuar |
|---|---|---|
| | | D |
| 704 | Transporti i mallrave | 2,004,180.33 |
| 705 | Transporti i udhëtarëve | 1,664,834.18 |
| 7045 | Shërbimet tjera | 188,634.74 |
| | TOTAL - Shitjet | 3,857,649.25 |
| B | Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve | |
| 6014 | Blerje/Shpenzime tjera | 7,527.20 |
| 6010 | Derivatet dhe lubrifikuesit | 1,153,419.06 |
| 604 | Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale | 32,238.86 |
| 6015 | Inventar dhe pajisje | 23,835.00 |
| 6013 | Material harxhues | 2,146.55 |
| 6012 | Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera | 118,592.25 |
| 605 | Shpenzimet e transportit - bileta dhe nafta për Infrakos | 67,303.96 |
| 606 | Qasja në binarë | 1,386,206.63 |
| 6016 | Sigurimi i palëve të treta | 4,665.60 |
| 6011 | Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj | 159,903.00 |
| | TOTAL - Kostoja e shërbimit | 2,955,838.11 |
| C (A-B) | Fitimi (humbja) bruto | 901,811.14 |
| D | Të ardhurat tjera | |
| 70 | Të hyrat tjera jo operative | 88,887.49 |
| 7088 | Mjetet e akumuluara | 419,793.00 |
| | TOTAL - Të ardhurat tjera | 508,680.49 |
| *I* | *TOTAL TË HYRAT* | *4,366,329.74* |
| E | Shpenzimet e stafit | |
| 64 | Pagat dhe kontributet | 1,370,014.92 |
| 64 | Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera | 33,315.08 |
| | TOTAL - Shpenzimet e stafit | 1,403,330.00 |
| F | Shpenzimet operative | |
| 615 | Mirëmbajtje dhe riparimi i objekteve | 75,403.64 |
| 616 | Sigurimi fizik Total | 31,288.12 |
| 617 | Shërbimet tjera | 2,399.13 |
| 627 | Shpenzimet logjistike | 19,252.91 |
| 618 | Energjia elektrike dhe shërbimet komunale | 25,542.43 |
| 619 | Sigurimi i palëve të treta | 5,754.16 |
| 621 | Donacionet e dhëna | 1,993.10 |

| | | |
|---|---|---|
| 624 | Marketingu | 32,678.32 |
| 625 | Udhëtimet zyrtare | 18,691.74 |
| 626 | Telefonat dhe Posta | 22,449.22 |
| 628 | Shërbimet bankare | 2,294.68 |
| 63 | Tatimet | 22,569.80 |
| 629 | Pajisje elektronike | 41,443.43 |
| | TOTAL - Shpenzimet operative | 301,760.68 |
| G | Shpenzimet administrative | |
| 603 | Inventar dhe pajisje | 11,846.95 |
| 620 | Konsulenca dhe auditimi i jashtëm | 9,985.00 |
| 602 | Material i zyrës | 10,201.08 |
| 614 | Material sanitar | 5,519.79 |
| 613 | Qiraja për objektet | 3,386.00 |
| 654 | Reprezentacioni dhe bufeja | 10,576.83 |
| 608 | Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet | 26,620.00 |
| 607 | Shpenzimet logjistike | 8,613.64 |
| 655 | Kontigjente | 25,000.00 |
| | TOTAL - shpenzimet administrative | 111,749.29 |
| II | TOTAL SHPENZIMET | 4,772,678.08 |
| H | FITIMI / HUMBJA nga veprimtaria operacionale (C+D-E-F-G) | -406,348.34 |
| | Shpenzimet e zhvlerësimit | |
| 1 | Shpenzimet e zhvlerësimit që ndikojnë në koston e shërbimit | -69,573.48 |
| 2 | Shpenzimet e zhvlerësimit që nuk ndikojnë në kosoton e shërbimit | -15,336.00 |
| I | TOTAL - Shpenzimet e zhvlerësimit | -84,909.48 |
| J (H+I) | Fitimi (humbja) nga veprimtaria/operacionet pas zhvlerësimit | -491,257.82 |

## 3. INVESTIMET KAPITALE PËR VITIN 2012

| BURIMI I FINANCIMIT | Viti 2012/€ |
|---|---|
| A) Buxheti operativ – TRAINKOS Sh.A. | 189,389.24 |
| B) Buxheti i Kosovës - BK | 1,200,000.00 |
| TOTAL INVESTIME KAPITALE | 1,389,389.24 |

**A) INVESTIMET KAPITALE PËR VITIN 2012 TË CILAT DO TË FINACOHEN NGA BUXHETI OPERATIV - TRAINKOS Sh.A.**

Tabela më poshtë paraqet projektet kapitale të cilat me rishikim janë paraparë të financohen nga buxheti operativ i Trainkos Sh.A. Këto projekte janë të përfshira në kategoritë përkatëse në planin e shpenzimit.

| Nr. | Projektet e financuara nga buxheti operativ i Trainkos Sh.A. për vitin 2012 | SHUMA/€ |
|---|---|---|
| 1 | Furnizimi me bateri për lokomotiva 661 | **10,080.00** |
| 2 | Pajisje për zbutjen e ujit | **7,560.00** |
| 3 | Riparimi i tornos | **22,680.00** |
| 4 | Furnizimi me konvertor | **25,200.00** |
| 5 | Pajisje për lokomotivën 009 | **7,425.60** |
| 6 | Rezervar për ujë te zbutur | **6,720.00** |
| 7 | Pajisje për furnizim të lokomotivave me vaj | **2,520.00** |
| 8 | Material për lokomotiva Di3 | **4,200.00** |
| 9 | Material për lokomotiva 661 | **4,200.00** |
| 10 | Material për lokomotiva G1700 | **4,200.00** |
| 11 | Material për trena motorikë | **4,200.00** |
| 12 | Riparim i objekteve administrative | **75,403.64** |
| 13 | Projekti për sistemin e menaxhimit të naftës | **15,000.00** |
| | **TOTALI:** | **189,389.24** |

**B) INVESTIMET KAPITALE PËR VITIN 2012 TË CILAT DO TË INVESTOHEN NGA BUXHETI I KOSOVËS**

Nga Buxheti i Kosovës (BK) për vitin 2012 janë paraparë grantet për TRAINKOS Sh.A në shumën prej 1,200,000.00€. Kjo shumë është destinuar për projektet e precizuara më poshtë dhe zbatimi i mëtutjeshëm i këtyre projekteve ndërlidhet me vazhdimin e mbështetjes nga BK-ja për vitin 2013. Buxheti i vogël dhe i limituar si dhe mundësia për të zbatuar projektet na detyron që projektet t'i planifikojmë për dy vite e më tepër.

| Përshkrimi | Viti 2012/€ | Viti 2013/€ |
|---|---|---|
| Riparimi gjeneral i lokomotivave | 800,000.00 | 800,000.00 |
| Riparimi i mesëm i trenave motorikë | 400,000.00 | 400,000.00 |
| Totali | 1,200,000.00 | 1,200,000.00 |

## ANEKSI 1
## Buxheti Operativ - sqarimet

Përshkrimi i detaleve të buxhetit të rishikuar operativ është bërë sipas divizioneve përkatëse të cilët korrespondojnë nga baza e njësisë buxhetore, konkretisht secili pozicion i ka të përfshira detalet sipas divizionit përkatës. Për të thjeshtësuar shpjegimet dhe precizuar burimin e kërkesës janë përdor shkurtesat si më poshtë:

1. TrM (Transporti i Mallrave);
2. TrU (Transporti i Udhëtarëve);
3. M (Marketingu);
4. ML (Mirëmbajtja e Lokomotivave);
5. MV (Mirëmbajtja e Vagonëve);
6. K (Kontrolli) dhe
7. DA (Departamenti i Administratës)

### A. Shitjet – TOTAL: 3,857,649.25€

**704. Transporti i Mallrave** me rishikim për vitin 2012 është i parashikuar të jetë 2,004,180.33€ dhe atë:

**7041-7042. Transporti Konvencional –** ku përfshihet transporti i mallrave me vagonë do të jetë 1,934,180.00€ € dhe

**7044. Transporti jo Konvencional –** ku parashihet transporti i mallrave me kontejnerë dhe kamion do të jetë 70,000.00€.

**705. Transporti i Udhëtarëve** me rishikim për vitin 2012 është i parashikuar të jetë 1,664,834.18€ dhe atë:

**7050612. Transporti Komercial i Udhëtarëve –** Me rishikim parashihet të jetë 223,523.34€. Këtu janë të kalkuluara të hyrat e planifikuara nga biletat për qarkullimin e trenave: TLL (Treni i Lëvizjes së Lirë)-32,153.85€, Treni i Shkupit dhe Treni i Pejës-191,369.49€.

**705061. Transporti i Subvencionuar i Udhëtarëve me rishikim** në total është 500,000.00€.

**7050611. Transporti i udhëtarëve i kontraktuar -** Shuma prej 941,307.84€ është buxheti i ndarë nga Buxheti i Kosovës për vitin 2012. Këtu janë të përfshira kalkulimet për qarkullimin e TLL-së në bazë të marrëveshjes së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës për vitin 2012.

**7045. Shërbime tjera -** shuma prej 188,634.74€ është nga kalkulimet për t'u paguar në emër të qëndrimit të vagonëve të huaj në territorin e Republikës së Kosovës.

### B. Kostoja e shërbimeve – TOTAL: 2,955,838.11€

Shpenzimet e mëposhtme janë shpenzimet që ndikojnë drejtpërdrejt në koston e ofrimit të shërbimeve tona.

**6014 – Blerje/Shpenzime tjera – 7,527.20€**

TrM – Qira për objektet e transportit (Volkovë) – 7,527.20€

**6010. Derivatet dhe Lubrifikantët – 1,153,419.06€**

ML – Vaj për mjete lëvizëse – 28,997.07€

TrU – Nafta për trenat e udhëtarëve – – 613,701.36€

TrM – Nafta për trenat e mallrave – 510,720.63€

**604. Energjia elektrike dhe shërbimet komunale – 32,238.86€**

DA – Blerje, Energji, avull dhe ujë – 2,349.22€; Energji elektrike për objektet e transportit/mirëmbajtjes – 29,563.75€; mbeturinat dhe uji – 1,325.89€ dhe ngrohja e objekteve të transportit /mirëmbajtjes – 3,000.00€.

**6015. Inventar dhe Pajisje – 23,835.00€**

K – Inventar i mirëmbajtjes së njësive të transportit – 2,700.00€.

MV –Destilator – 500.00€; Instrument për tension të lartë (1500V) – 800.00€ dhe Pajisje për pastrim – 100.00€

ML – Pajisje për zbutjen e ujit – 7,560.00€ dhe Rezervuar për zbutjen e ujit 6,720.00€ dhe Pajisje për furnizim të lokomotivave me vaj – 2,520.00€.

TrU– Inventar i mirëmbajtjes së njësive të transportit – 800.00€.

TrM - Inventar i mirëmbajtjes së njësive të transportit – 2,135.00€

**6013. Material harxhues – 2,146.55€**

TrM – Rërë për lokomotiva – 1,645.55€ dhe Shirita për shpejtësi matës – 500,00€.

**6012. Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera – 118,592.25€**

MV **–** Materiale tjera për dëmtimet në punëtori – 1,500.00€; Material për vagonë të mallrave dhe udhëtarëve – 9,240.00€ dhe Riparimi i tornos 27,000.00€ dhe Kalibrimi i pajisjeve dhe riparimi i kompresorit – 5,000.00€ dhe Mirëmbajtje dhe riparime për makineritë – 5,121.10€.

ML – Materiale tjera – 1,350.00€, Furnizim me konvertor – 25,200.00€; Furnizim me bateri për lokomotiva – 10,080.00€; Pajisje për lokomotiva 009 – 7,425.06€; Pjesë ndërrimi – 6,361.59€; Mirëmbajtje dhe riparime për makineri –275.00€; Material për lokomotiva Di3 – 5,000.00€; Material për lokomotiva 661 – 5,000.00€; Material për lokomotiva G17000 – 5,000.00€ dhe Material për trena motorikë – 5,000.00€.

TrM – Material për njësitë e transportit – 39.50€

**605. Shpenzimet e transportit – biletat dhe nafta për Infrakos – 67,303.96€**

DA - Nafta për Infrakos – 60,062.83€

TrU - Shtypja e biletave komerciale – 3,263.30€ dhe shtypja e biletave nga donacioni – 3,977.83€

**606. Qasja në binarë – 1,386,206.63€**

TrU – Qasja në binarë Transporti i udhëtarëve – 796,129.33€

TrM - Qasja në binarë Transporti i mallrave – 590,077.30€

**6016. Sigurimi i palëve të treta – 4,665.60€**
DA – Sigurime për trenat e udhëtarëve – 4,665.60€.

**6011. Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj – 159,903.00€**
TrU - Tërheqja e trenit mallra/udhëtarëve nga Hekurudhat Maqedone (HM)– 5,500.00€.
TrM – Tërheqja e trenave të mallrave nga HM – 10,000.00€; fjetja - dëmtimi i vagonëve – 17,870.00€; Transporti derë me derë nga nënkontraktori me kamion – 13, 987.00€ dhe Shpenzimet e RIV-it 112,546.00€.

**D. Të ardhurat tjera – TOTAL: 508,680.49€**

**70. Të hyrat tjera jooperative – 88,887.49€.**
DA – Të hyrat nga shitja e naftës për Infrakos – 60,062.83€
MV – Të ardhurat nga shitjet tjera (mirëmbajtja e vagonëve) – 28,824.66€.

**7088. Mjetet e akumuluara – 419,793.00€.**
DA – Mjetet e akumuluara – 419,793.00€.

**E. Shpenzimet e stafit – TOTAL: 1,403,330.00€**

**641 dhe 645. Pagat dhe kontributet – 1,370,014.92€**
DA- Shpenzime për personelin – 1,306,162.76€ dhe Kontributet pensionale 5% nga punëdhënësi – 63,852.16€.

**644, 645 dhe 648. Sigurimi shëndetësorë, trajnime dhe shpenzime - 33,315.08€**
DA - Sigurimet shëndetësore – 3,480.00€; Shpenzimet e trajnimit, edukimit të personelit – 9,255.08€ dhe shpenzime të tjera për personelin – 20,000.00€.
TrM – Sigurimet shëndetësore – 580.00€.

**F. Shpenzimet operative – TOTAL: 301,760.68€**

**615. Mirëmbajtja dhe riparimi i objekteve – 75,403.64€**
DA- Renovimi i Objektit të ish Ambulancës – 58,475.14€; Renovimi i ngrohtores – 8,000.00€; Rregullimi i Objekteve të depos së naftës – 5,000.00€; dhe Renovimi i pjesshëm i zyrave të objekteve të mirëmbajtjes – 2,928.50€.
TrM – Mirëmbajtje dhe riparime për njësitë transportit dhe mirëmbajtjes – 1,000€

**616. Sigurimi fizik – 31,288.12€**
DA – Sigurimi fizik i objektit – 31,288.12€.

**617. Shërbimet tjera –2,399.13€**

TrU – Shpenzimet e shpedicionit – 200.00€
TrM – Shtypja e formularëve 1,000.00€ dhe Shpenzimet e shpedicionit – 1,199.13€.

**627. Shpenzimet e transportit – 19,252.91€**
DA - Kjo shumë është e paraparë të shpenzohet për derivatet e naftës për mjetet transportuese – 19,252.90€.

**618. Energjia elektrike dhe shërbimet komunale – 25,542.81€**
DA – Energjia elektrike për objektet e administratës – 16,878.44€; Ngrohja për objektet e administratës – 5,471.39€; Mbeturinat dhe uji 1,342.98€.
TrM – Energjia për objekte – 1,850.00€.

**619. Sigurimi i palëve të treta – 5,754.16€**
Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: sigurimin e veturave – 2,794.16€ dhe kontrollet shëndetësore sistematike – 2,960.00€.

**621. Donacionet e dhëna – 1,993.10€**
M - Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për sponsorimin e aktiviteteve të ndryshme brenda tërë vitit 2012 – 1,993.10€.

**624. Marketingu dhe publikimet – 32,648.32€**
DA – Konkurse dhe shpallje – 500.00€ .
M – Publicitet dhe reklama – 5,979.55€; Shtypja e reklamave dhe fllajerave të ndryshëm – 21,693.77€ dhe shpenzimet tjera të marketingut – 4,475.00€.

**625. Udhëtimet zyrtare – 18,691.74€**
DA - Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për udhëtime zyrtare për përfaqësim – 16,191.74€ dhe realizimin e projekteve - 2,500.00€. Në këto pozicione janë përfshirë shpenzimet e hotelit, udhëtimet me aeroplan, mëditjet, shpenzimet për viza dhe udhëtimet lokale.

**626. Telefonat dhe Posta – 22,449.22€**
DA - Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për: Shpenzimet e internetit – 1,138.00€; Shpenzimet e telefonave mobil – 7,295.71€; Shpenzimet e telefonave fiks dhe faksit – 12,153.00€ dhe Posta dhe dërgesa – 1,862.51€.

**628. Shërbimet bankare – 2,294.68€**
DA - Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për provizionet bankare brenda vitit 2012 – 2,294.68€.

**63. Tatimet – 22,569.80€**
DA - Kjo shumë është paraparë të shpenzohet për pagesën e tatimeve në të ardhurat personale – 22,569.80€.

**629. Pajisjet elektronike – 41,443.43€**
DA – Sistemi i menaxhimit të naftës – 15,000.00€ dhe Pajisje elektronike, kompjuterë dhe të tjera – 25,433.43€.
TrM - Pajisje elektronike, kompjuterë dhe të tjera – 1,000.00€

## G. Shpenzimet administrative - TOTAL: 111,749.29€

**603. Inventar dhe pajisje – 11,846.95€**
DA – Shpenzimet e inventarit/material për zyre – 11,846.95€.

**620. Konsulenca dhe auditimi i jashtëm – 9,985.00€**
DA – Shërbimet e këshillimeve/Konsulencës – 6,385.00€ dhe Shpenzimet e Auditimit – 3,600.00€.

**602. Material për zyre – 10,201.08€**
DA – Shpenzimet për zyre (letër, toner, etj) – 4,980.72€; Shpenzimet administrative – 4,050.00€ dhe Material shpenzues – 1,025.86€.

**614. Material sanitar – 5,519.79€**
DA – Shpenzimet e higjenës – 3,519.79€
TrU – Shpenzimet e higjenës – 1,500.00€ dhe material sanitar dhe medicinal – 300.00€
TrM - Material sanitar dhe medicinal – 200.00€.

**613. Qiraja dhe objektet – 3,386.00€**
DA – Qiraja për antenën në Berishë – 3,386.00€.

**654. Reprezentacioni dhe bufeja – 10,576.86€**
DA – Shpenzimet për reprezentacion dhe përfaqësime – 5,766.90€ dhe Shpenzimet e bufesë – 4,809.93€.

**608. Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet – 26,620.00€**
DA – Shpenzimet e Gjykatës/Gjyqësore – 26,594.00€ dhe Gjoba dhe dëmshpërblime – 26.00€.

**607. Shpenzimet logjistike – 8,613.64€**
DA – Parking dhe autolarje – 848.28€; Regjistrimi i automjeteve – 1,500.00€; mirëmbajtja e automjeteve – 5,265.36€ dhe shërbime tjera operative – 1,000.00€.

**655. Kontigjente – 25,000.00€**
DA - rezerva kontingjente të Kryeshefit Ekzekutiv – 27,939.17€.

**I. I. Shpenzimet e zhvlerësimit - TOTAL: 84,909.48€**

**I.1.** Shpenzimet e zhvlerësimit që ndikojnë në koston e shërbimit –-69,573.48€. Këtu është përfshirë zhvlerësimi i aseteve dhe të tjerave që ndikojnë direkt te kostoja e shitjes. Duhet ta kemi parasysh se kalkulimet janë bërë në bazë të vlerës së aseteve nga pasuria që e kemi me investime vetanake. Pra nuk është vlera totale e amortizimit pasi do të duhej të reflektonte edhe si e hyrë e shtyrë.

I. 2. Shpenzimet e zhvlerësimit që nuk ndikojnë në Koston e shërbimit –-15,336.00 €. Kjo shumë e kalkuluar po ashtu me gjendjen e veturave të Trainkos Sh.A.